

**VKM**

**Nr.456, datë 16.4.2008**

**PËR PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES, SI DHE KRITERET E PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË TRUALLIT FAMILJEVE, QË PËRFITOJNË BANESA ME KOSTO TË ULËT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 17 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, përcaktohet sipas vlerave të tregut. Për trojet, pronë e shtetit, çmimi i shitjes përcaktohet sipas vlerave të miratuara, për efekt të kompensimit të pronave. Për qytetet, për të cilat nuk është miratuar ende vlera e truallit, të përdoren, për referencë, vlerat e qytetit më të afërt.

2. Për familjet me të ardhura më të larta se 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë për frymë, çmimi i shitjes së truallit të jetë sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Për familjet me të ardhura për frymë, nga 9000 (nëntë mijë) lekë 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë, çmimi i shitjes së truallit të jetë sa 50 për qind e çmimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Familjet me të ardhura nën 9000 (nëntë mijë) lekë për frymë nuk paguajnë për çmimin e truallit.

5. Verifikimi i nivelit të të ardhurave bëhet në mbështetje të vendimit nr.53, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira".

6. Kriteret për përcaktimin e çmimit të shitjes së truallit familjeve, që trajtohen me banesë me kosto të ulët, të përdoren edhe nga Enti Kombëtar i Banesave për objektet e ndërtuara, për të cilat nuk janë lidhur ende kontratat e shitblerjes, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 1 të nenit 39/1 të ligjit nr.9232, datë 13.2.2004 "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane", të ndryshuar.

7. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI Sali Berisha